

*Specialist (SOC 1, 24/7 *3 turne)/Sektori i Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve Kibernetike (SOC 1 + SOC 2), Drejtoria e Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve, Qendrës Operacionale SOC C-SIRT, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:*

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/2024, “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783, datë 18.12.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024, “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, urdhrin të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 3 (tre) vende të lira pune në pozicionin:

- **Specialist (SOC 1, 24/7 *3 turne)/Sektori i Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve Kibernetike (SOC 1 + SOC 2), Drejtoria e Monitorimit dhe Reagimit të Incidenteve, Qendrës Operacionale SOC C-SIRT, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Përbush detyrat funksionale në zbatim të legjislacionit në fuqi, për fushën e veprimit të Autoritetit, si dhe atë për ruajtjen e të dhënave personale;
- Raporton tek eprori për rastet e mosrespektimit të standardeve të sigurisë dhe propozon masa për rregullimin e situatës;
- Ndihmon me zhvillimin e planeve të reagimit ndaj incidenteve, rrjedhave të punës dhe procedurave standarde të funksionimit;
- Shënon incidentet dhe alertet në raport ditor, duke evidentuar nëse janë zgjidhur ose janë ende në proces investigimi;
- Krijon dhe rishikon planet dhe raportet mujore mbështetur në analiza;
- Kryen në mënyrë proaktive kërkime të trafikut të rrjetit të pajisjeve dhe aktivitetit të sistemit duke kërkuar aktivitete të dyshimta (procese të dyshimta);
- Analizon trafikun e rrjetit dhe lojet nëpërmjet teknikave dhe mjeteve të specializuara për përbushjen e detyrave funksionale, në zbatim të legjislacionit në fuqi për fushën e veprimit të Autoritetit, si dhe atë për ruajtjen e të dhënave personale;
- Harton raporte të detajuara mbi gjetjet dhe indikatorët e kompromentimit (IoC), alertet, analizën e tyre, si dhe masat e ndërmarra për zgjidhjen e tyre;

- Harton regjistrin e detajuar të aktiviteteve dhe gjetjeve, bazuar në aktivitetin monitorues 24/7 dhe në platformat e monitorimit;
- Merr pjesë në trajnimet periodike të ekipit të Qendrës së Operacioneve të Sigurisë.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Bachelor” në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në profesion. Përbën avantazh eksperiencë e punës në fushën e Teknologjisë së Informacionit, nga e cila minimalisht 6 muaj në fushën e sigurisë dhe/ose monitorimit të rrjeteve apo sistemeve dhe/ose sigurisë.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Teknikat e sulmeve kibernetike dhe aplikacioneve që përdoren për këtë qëllim;
- Njohuri mbi protokollet e rrjetave kibernetike;
- Njohuri mbi metodat e sulmeve kibernetike;
- Njohuri mbi aplikacionet dhe platformat që përdoren për Sigurinë Kibernetike;
- Njohuri mbi fushën e sigurisë së informacionit;
- Vlerësimin e dobësive dhe sigurinë e rrjetit.

Aftësi për të:

- Përvojë në monitorimin e rrjetit, analizën e incidenteve dhe përdorimin e mjeteve të specializuara të sigurisë;
- Të kenë aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe dokumentimit, si dhe aftësi të mira zgjidhje-problemi dhe zgjidhje të shpejta në situata kërcënimi;
- Organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-2)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 09.04.2026, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@aksk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.